

Instruksione për licencimin e shoqërive të sigurimit

Shoqëria e sigurimit ka objekt të veprimtarisë së saj vetëm veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe operacionet që rrjedhin drejtpërdrejt nga këto veprimtari, duke përjashtuar çdo veprimtari tjetër tregtare.

Forma juridike e shoqërisë së sigurimit është shoqëri anonime (**sh.a**)

Veprimtaria e sigurimit ushtrohet nga shoqëri sigurimi me seli në territorin e Republikës së Shqipërisë të licencuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, si dhe dega e shoqërisë së huaj të sigurimit, e licencuar nga AMF.

Shoqëria e sigurimit ushtron veprimtari sigurimi, vetëm për klasat që janë licencuar nga Autoriteti.

Shoqëria licencohet si:

1. Shoqëri sigurimi ose degë e shoqërisë së huaj;
2. Shoqëri risigurimi ose degë e shoqërisë së huaj;
3. Shoqëri sigurimi dhe risigurimi ose degë e shoqërisë së huaj sigurimi dhe risigurimi.

Llojet e licencës për shoqëritë e sigurimit janë:

- a. Licencë për ushtrim veprimtarie;
- b. Licencë për zgjerim veprimtarie;
- c. Licencë për ushtrim veprimtarie të degës së shoqërisë së huaj.

Licenca është e pakufizuar në kohë, e patransferueshme dhe e patregtueshme.

Licencimi i veprimtarisë së sigurimit kalon në dy faza:

- a. Miratim paraprak;
- b. Licencim përfundimtar.

FAZA E PARË

*Gjatë fazës së **miratimi paraprak**, shoqëria e sigurimit që aplikon për marrje licence, duhet të plotësojë kërkesat e paraqitura në formularët e mëposhtëm:*

(Formulari 1) - Kërkesën për t'u pajisur me licencë për të vepruar si shoqëri sigurimi, në të cilën paraqitet informacion mbi emrin dhe adresën e selisë dhe klasat e sigurimit për të cilën po aplikohet.

(Formulari 2) - Vendimin e këshillit mbikëqyrës të shoqërisë në lidhje me personin, i cili do të përfaqësojë shoqërinë në lidhje me Autoritetin.

(Formulari 3) - Njoftim publik në lidhje me aplikimin e bërë në Autoritet.

(Formulari 4) - Të dhëna të përgjithshme në lidhje me shoqërinë e re (emri dhe adresa, madhësia e kapitalit aksioner, emrat e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe anëtarëve të drejtorisë).

(Formulari 5) - Informacion mbi aksionerët e shoqërisë (emri mbiemri i aksionerit, nr. i aksioneve në zotërim, vlera nominale e aksioneve që mban secili, përqindja e mbajtjes së kapitalit aksioner).

(Formulari 6) - Informacion për aksionerët kryesorë me pjesëmarrje influencuese (emër-mbiemër, kombësia, adresat).

(Formulari 7) - Informacion mbi eksperiencën e punës gjatë 3 viteve të fundit për aksionerët me pjesëmarrje influencuese mbi 10% të aksioneve.

(Formulari 8) - Informacion i përgjithshëm mbi asamblenë aksionere, këshillin mbikëqyrës dhe anëtarët e drejtorisë (edukimi, eksperiencia profesionale dhe punësimit aktual, deklaratë mbi të dhënat kriminale, informacion mbi çdo lloj biznesi në të cilin ka më shumë se 10% të aksioneve, detyrimet tatimore).

(Formulari 9) - Informacion mbi themeluesit e shoqërisë së sigurimit (emri, mbiemri, adresa kombësia).

(Formulari 10) - Raporti financiar personal sekret (çdo aksioner deklaron burimin e të ardhurave, aktivet e tij, detyrimet).

(Formulari 11) - Informacion mbi infrastrukturën e shoqërisë (vendndodhjen e zyrave qendrore, adresa, sip. në m², çmimi i blerjes ose qerasë, vendndodhja e degëve të shoqërisë së sigurimit).

(Formulari 12) - Akt themelimi i shoqërisë së sigurimit.

(Formulari 13) - Projektstatuti i shoqërisë së sigurimit.

(Formulari 14) - Ky formular shoqërohet nga dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Certifikatë bankare për pagesën e ½ të kapitalit themeltar dhe shpenzimet e nisjes (kufiri minimal i kapitalit themeltar = fondi i garancisë).
2. Program i veprimtarisë, në përputhje me nenin 24 të ligjit, i cili përmban: Klasat e sigurimeve për të cilat kërkon të licençohet; Parashikimet për kalimet në risigurime, duke përfshirë tabelat e mbulimeve maksimale për të gjitha klasat e sigurimeve; Llogaritjen e nivelit të kërkuar të aftësisë paguese; Elementët që përbëjnë fondin e garancisë; Parashikimi i detajuar i shpenzimeve të nisjes; Kushtet e përgjithshme të kontratave të sigurimit për klasat që kërkon të licençohet; Tarifat dhe primet që parashikon të zbatojë për klasat që kërkon të licençohet dhe mënyrat e llogaritjes së tyre.
3. Përlllogaritje të aftësisë paguese dhe nivelit të kërkuar të saj dhe metodat e përdorura për përlllogaritjen e tyre;
4. Të dhëna mbi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe anëtarët e drejtorisë (Diploma universitare, kualifikime profesionale, të dhëna mbi gjendjen gjyqësore, deklaratë për mos pasjen e pengesave ligjore për ushtrimin e funksioneve).

(Formulari 15) - Format i shkurtuar i bilancit financiar dhe pasqyrave financiare.

(Formulari 16) – Pasqyra financiare (humbje/fitime), ku përfshihen : parashikimet për primet dhe dëshmipërblimet pasqyrën e rrjedhjes së parasë, burimet financiare për të përmbushur detyrimet që do të marrë përsipër shoqëria, fitimin e parashikuar, llogaritjen e provigjoneve teknike dhe metodave të përdorura për llogaritjen e tyre.

(Formulari 17) - Gjendja e fondeve kapitale.

Programi i veprimtarisë hartohet për 3 vitet e para të veprimtarisë për shoqëritë e jo- jetës dhe për 7 vitet e para të veprimtarisë për shoqëritë e jetës.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka të drejtë t'i kërkojë shoqërisë së sigurimit informacion shtesë në lidhje me:

1. Draft kontratat për operacionet të lidhura me palë të treta, të cilat lidhen me funksione specifike me shoqërinë e sigurimit, për sa kohë që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë e saj.
2. Emrat e bankave me të cilat shoqëria e sigurimit do të operojë.

FAZA E DYTË

Për licencimin përfundimtar, shoqëria e sigurimit duhet të depozitojë në AMF sa më poshtë:

1. Ekstraktin e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, së bashku me aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë së sigurimit.
2. Vërtetimin e depozitimit të gjysmës tjetër të kapitalit themeltar dhe të fondit të shpenzimeve të nisjes.
3. Vërtetimin e pronësisë ose të kontratës së qirasë për mjediset ku do të ushtrohet veprimtaria e sigurimit.
4. Aktin e emërimit të anëtarëve të drejtorisë dhe të këshillit mbikëqyrës, së bashku me një përshkrim të shkurtër të kompetencave të tyre, si dhe specifikimet e nënshkrimit.
5. Aktin e emërimit të ekspertit kontabël të autorizuar.
6. Specimene të kontratave të sigurimit sipas klasave, të kërkuara prej saj.

Autoriteti përveç kërkesave të parashikuara, ka të drejtë të kërkojë informacion shtesë në lidhje me dokumentacionin e paraqitur, mosdhënia e të cilave mund të përbëjë shkak për refuzimin e licencës.

Brenda 6 muajve nga data e pranimit të kërkesës për licencë, Autoriteti jep ose refuzon miratimin paraprak dhe njofton me shkrim shoqërinë për vendimin e tij. Data e pranimit të kërkesës për licencë është data kur shoqëria ka plotësuar të gjitha kërkesat e këtij ligji dhe rregulloreve të Autoritetit. Vendimi i Autoritetit për miratim ose refuzim paraprak i bëhet i ditur shoqërisë me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike, nga data e marrjes së vendimit përkatës.

Autoriteti shqyrton kërkesën për licencim përfundimtar brenda dy muajve nga data e depozitimit të dokumenteve të plotësuar. Autoriteti ka të drejtë të shtyjë afatin e shqyrtimit të kërkesës deri në tre muaj, në raste objektivisht të vërtetueshme, për të cilat atij i duhet koha e nevojshme për shqyrtim.

BAZA LIGJORE

Ligji nr. 9685, datë 26.02.2007 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Ligji nr. 9338, datë 16.12.2004 “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Ligji nr. 9267, datë 29.07.2004 “Për veprimtarinë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”.

Rregullore e Autoritetit nr. 13, datë 08.02.2007 “Për procedurat e pranimi dhe shqyrtimit të kërkesave për dhënien e licencave për të ushtruar veprimtari sigurimi dhe risigurimi në Republikën e Shqipërisë”.